# DËSHMI ARKIVI

**A-441764**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | A rrezikohen shqiptarët nga politikat e AfD-së në Gjermani? Deputeti Tobias Teich sqaron qëndrimin e tij |
| ADRESA | `https://albeu.com/kosove/a-rrezikohen-shqiptaret-nga-politikat-e-afd-se-ne-gjermani-deputeti-tobias-teich-sqaron-qendrimin-e-tij/1010198/` |
| BURIMI | albeu.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 13 shtator 2026, 21:02:02 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 13 shtator 2026, 20:57:38 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `6ccb7fb96570ca57cbb88f3e0f715e4fe8e2c35d06cf2ddb437620246adabd6e` |
| TEKSTI | `21dc1051ecb2a4381bae27b5c4f69081a686f340b47a63d1a53d3476b2c70220` |
| PAMJA | `f8b625b3e3f7d27a022c0407a8cf491326675e83ec70a569fd251dcd52c067af` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `3c1a5c99b24feb56f797cf3a395c3d58eb5eb2e21b380b87785d56a5ccc964e0` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `5a17c12c14e78c5a4225635ca4dd5bf0de00406a8b7800bc862a616c14968175` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/3c1a5c99b24feb56f797cf3a395c3d58eb5eb2e21b380b87785d56a5ccc964e0`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# A rrezikohen shqiptarët nga politikat e AfD-së në Gjermani? Deputeti Tobias Teich sqaron qëndrimin e tij



Pas fitores së AfD-së në Gjermani, deputeti Tobias Teich foli për qëndrimin e partisë ndaj emigracionit dhe mundësinë që shqiptarët të preken nga këto politika. Sipas tij, fluksi më i madh i emigrantëve nuk lidhet me Shqipërinë.

Teich veçoi Sirinë dhe vendet afrikane si zonat prej të cilave vijnë numri më i lartë i emigrantëve dhe që konsiderohen më problematike. Ai tregoi gjithashtu për kontaktet e tij me komunitetin kosovar dhe shqiptar, si dhe për mënyrën se si e ka njohur historinë e Kosovës dhe Shqipërisë.

Deputeti tha se Gjermania ka shpenzuar 12 miliardë euro gjatë vitit 2024 për çështjet që lidhen me azilkërkuesit. Ai theksoi se personat që mbërrijnë nga vende të tjera, integrohen në shoqërinë gjermane, respektojnë kulturën dhe sistemin e vendit, janë të mirëpritur dhe nuk përbëjnë problem.

Ai nënvizoi se diskutimi nuk ka të bëjë vetëm me shqiptarët, duke kujtuar se gjatë viteve 90 Gjermania priti një numër të madh refugjatësh nga Kosova. Teich tha se ka lindur në vitin 84 dhe se i përket një brezi që ka parë ardhjen e shumë njerëzve në Gjermani për t'u larguar nga konfliktet dhe për të gjetur siguri.

Sipas tij, kontakti me të rinj nga Kosova e ndihmoi të mësonte për historinë e saj, ndërsa më vonë ai u njoh edhe me Shqipërinë. Teich deklaroi se ka krijuar një vlerësim pozitiv për komunitetin shqiptar në Gjermani, veçanërisht kur çështja shqyrtohet përmes të dhënave statistikore mbi kriminalitetin.

"Nuk kemi probleme me njerëzit që kanë ardhur nga Shqipëria. Numrin më të madh të emigrantëve e kanë vendet si Siria dhe shtetet afrikane, jo Shqipëria", u shpreh ai.

Teich sqaroi se ky ishte vlerësimi i tij personal dhe se nuk mund të fliste domosdoshmërisht në emër të të gjithë

të fundit/


Foshnja 11-muajshe u raportua e zhdukur në Turqi, por nëna zbulo…


NZZ: Agush Buja rrëfen rolin kyç të Zvicrës në organizimin dhe…


17-vjeçarja gjermane denoncon sulm seksual pas një nate në Rimi…


"Rama na preu në besë"/ Divjaka shënon ditën e 45-të të…


Përplasje me armë në Anavyssos, Alket Rizai në kërkim para rikthi…


Edon Zhegrova shënon golin e parë në Serie A me Juventusin ndaj…


Trump njofton në Irlandë heqjen e tarifës 10% për uiskin irlandez

Aleanca për Media Etike ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

partisë. Megjithatë, ai përsëriti se për Shqipërinë ka një opinion pozitiv. Deklaratat u bënë në emisionin “Review”, të moderuar nga Greta Topjana në Euronews Albania.

Ndërkohë, në një sondazh të ri mbarëkombëtar të publikuar të dielën, Alternativa për Gjermaninë (AfD), parti e ekstremit të djathtë, ka rritur avantazhin ndaj bllokut konservator të Kancelarit Friedrich Merz.

Shtuar më 13.09.2026 22:57

Tags: AFD , deputeti , Tobias Teich



NZZ: Agush Buja rrëfen rolin kyç të Zvicrës në organizimin dhe financimi…




Kosova blindohet” para vendimit të Hagës, Policia e Kosovës sqaron masat e…



Kryeministri Kurti shpalos planin e qeverisjes dhe ekipin e ri ministror para…



LVV dhe LDK dakord për një kandidat konsensual për presidentin, Kraki: Së…



Këta janë 15 kandidatët që pritet të marrin mandatet e ministrave të Qeverisë K…



Shehu shpjegon prapavijën e “parashikimeve” të Vuçiqit për Gjykatën Speciale




BSPK kërkon zbatimin e zotimeve qeveritare për punëtorët




PDK-ja të hënën kërkon interpretim nga Kushtetuesja për…

© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko… Kërko



© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.